

## Genc K. Hoti - Përse u ribotua "Fitorja e Hidhur"?

Contributed by Jozef Martini  
Monday, 12 January 2015

Përse u ribotua "Fitorja e Hidhur"?

Genc K. Hoti

Perse u ribotua "Fitorja e hidhur"?

Genc K. Hoti

Produkti intelektual enverist akoma nuk e ka kuptuar se cdo prodhimtari në fushën historike pas 1991-shit do t'i nënshtrohet sites kritike, pasi cdo veper përpara këtij viti ka qene, në mënyrë absolute, pjesë e manipulimit dhe indoktrinimit të Popullit Shqiptar. E me qene se pretendohet që në Shqipëri është ndërruar rendi shoqëror me produktin intelektual enverist nëpër kembë dyshimi është në shkallën më sipërore për cdo krijimtari në fushën e historisë teorike e praktike. Por realisht kjo tregon se në Shqipëri është kaluar nga forma më të lartë e organizimit të shtetit klasor në formën fillestare të tij. Përgjithësisht kjo mbahet e fshehtë dhe nuk i tregohet Popullit Shqiptar. Vini se re çfarë ka ndodhur e po ndodh me të dhënat statistikore të formimit të PKSh dhe si manipulohet historia në këtë rast.

Para njezet e më shumë vjetësh pata marrë nismën për të zbuluar autorët e vertetë të partise komuniste shqiptare të drejtuar nga Enver Hoxha. Lexime e shumta në këtë drejtim për shumë e shumë vjet ma lehtësuan punën dhe brenda katër vjetëve (1992-1996) e mbarova. Une e konsideroj historinë e PKSh si historinë më të rëndësishme për gjatë shekullit të XX-te, por dhe atë që shqiptarët nuk e dinë pothuajse në asnjë element. Përfundimet ishin më të vertetë shumë sensacionale dhe pikepyetje më të para që më lindi në atë kohë ishte: a e kishin lexuar më të vertetë shqiptarët korpusin prej 71 vëllimesh të Enver Hoxhës, apo thjeshtë e kishin shfletuar? E them këtë pasi në këtë korpus gjendet një histori krejt tjetër për tjetër nga ajo që kisha bërë une dhe gjithë shqiptarët në arsimin e detyrueshëm (une e kam bërë tre herë këtë libër në tre shkallë të arsimit).

Po t'i shtosh këtyre veprave dhe materialin paralel të gjendur anë e kënd gjithë Shqipërisë kisha zbuluar:

1 – Në Shqipëri nuk kishin ekzistuar grupet komuniste, por kishte ekzistuar partia komuniste e Shkodrës me dege në të gjithë Shqipërinë me kryetar Zef Malen. Por manipulatoret e historisë së Kombit Shqiptar e kishin shtrembëruar këtë të vertetë absolute (mund të përmend me radhë Enver Hoxhën, Kristo Frasherin, Paskal Milon, Beqir Meten, Agim Musten dhe të gjithë ata që u komanduan të shkruanin mbi historinë e komunizmit shqiptar).

2 – Përgjate tre vjetëve (1942-1944) ishin asgjësuar pothuajse të gjithë anëtarët e kësaj partie dhe këtë akt e kishin kryer kryesisht dy jugosllavët: Miladin Popović dhe Dushan Mogosha. Kjo është pika më e rëndësishme dhe e parë që duhet saktësuar për të kuptuar realisht përmasën e luftës nacional-clirimitare.

3 – Pas asgjësimit të kësaj partie, në mars 1943 në Labinot të Elbasanit ishte formuar një parti komuniste me sekretar të përgjithshëm Enver Hoxhën. Dhe është kjo parti që mori përsiper të gjithë doktrinën e komunizmit historik shqiptar.

4 – Këtë parti të fundit nuk e kishin formuar as jugosllavët dhe as shqiptarët. Por partinë Komuniste Shqiptare të Enver Hoxhës na e kishin formuar britanikët.

Në veprën teorike të Enver Hoxhës e kisha gjetur më kohë që partia nuk ishte formuar më 8 nëntor 1941 në shtëpinë e Zylfije Canit (Vepra 12, f. 310; Kongresi i I-re i PKSh, f. 61, Tiranë 1950). Por vepra që më vulosi vendin dhe datën e formimit të partise së Enver Hoxhës na ishte përkishtë libri i Reginald Hibbert-it "Fitorja e hidhur", Tiranë 1993. Libri ishte përkthyer nga Xhevat Lloshi dhe në fund ka shënime për përkthimin ku, midis të tjerash, shkruhet: "Përkthimi i është përmbytur me besnikëri origjinale. Meqë ky është një punim historik, i mbeshtetur gjerësisht në dokumente, gjatë përkthimit janë bërë përpjekje për t'u lehtësuar lexuesve e studiuesve punën" (f. 417). Jam i detyruar të vendos këtë shenim për të treguar punën serioze të shtepisë botuese të Lidhjes së Shkrimtarëve, e cila tashmë nuk ekziston më.

Por ky liber kishte nje fraze te mallkuar deri ne vetmohimin e te gjithe kastes se historianeve shqiptare te epokes enveriste qe ishin marre me kete problem. Ata ose e kishin GENJYER te gjithe Popullin Shqiptar nga padija duke grabitur pa fund te gjithe rrogat e ekzistences se tyre, ose kishin GENJYER me dashje duke marre pjese ne manipulimin e Popullit Shqiptar. Per 48 vjet me rralle ne Shqiperi ishte festuar 8 Nentori 1941 si date e themelimit e partise kur ne realitet kjo date ishte nje fantazi e Enver Hoxhes per te mbuluar thelbin e nje lufte qe kishte pasur permasa krejt te tjera. Vini re se cfare shkruhet ne kete liber:

“Anetaret e Komitetit Qendror ishin ata qe ishin zgjedhur ne Konferencen themeluese te PKSH ne Labinot ne mars 1943” (nenvizimi i imi, f. 334)

Me 2004 pata perfunduar studimin mbi veprimtarine e Enver Hoxhes, qe e pata publikuar ne [www.albanovaonline.com](http://www.albanovaonline.com); ndersa me 08.11.2007, e ne vazhdim, ne TV KOHA pata dhene disa emisione (FOKUS) per keto tema me gazetarin Robert Papa, por nuk ma vuri veshin njeri edhe pse ato u perseriten pas nje viti (2008). Te vetequajturit historiane vazhdonin te shkruanin pa pergjegjesi duke e konsideruar 8 nentorin 1941 si te vetmen date te sakte, edhe pse nuk paraqiste ndonje rendesi politike, duke mos u mbeshtetur ne asnje dokument konkret. Genjeshtra e Enver Hoxhes kishte bere kaq shume vend ne ndergjegjen e shkaterruar te shqiptareve sa zbulimi im jo vetem qe nuk kishte rene ne sy, por ai kishte sherbyer si shtytje per rishikimin e historise sipas te njejtes platforme (Kristo Frasher, Historia e levizjes se majte ne Shqiperi dhe e themelimit te PKSH-se 1878-1941, Tirane 2006; Agim Musta, Libri i zi i Komunizmit shqiptar, Tirane 2007; Paskal Milo, Shqiptaret ne luften e dyte boterore, Vell. I, Tirane 2014).

Cdo gje do te kishte mbetur ne heshtje neqoftese nuk do te kishte ndodhur nje ngjarje qe me detyroi t'i rikthehem edhe nje here ketij problemi. Pashe ne lajme se ishte ribotuar libri i Reginald Hibbert-it “Fitorja e hidhur” dhe mendja me shkoi direkt tek fraza e mallkuar. E diskutova me Jozef Martinin dhe ngula kembe, pa ditur asgje konkrete, se duhet te kishin ndryshuar dicka te lidhur pikerisht me kohen dhe vendin e themelimit te PKSH. Gjetja e librit dhe leximi i tij çuan ne zbulimin e meposhtem, pikerisht ne ate vend qe kisha pretenduar. Edhe ne kete ribotim perkthyesi nuk kishte pertuar te rishkruante: “Perkthimi i eshte permbajtur me besnikeri origjinalit. Meqe ky eshte nje punim historik, i mbeshtetur gjeresisht ne dokumente, gjate perkthimit jane bere perpjekje per t’u lehtesuar lexuesve e studiuuesve punen” (f. 437). Botimi konsiderohej i ri dhe i plotesuar, ndersa fraza historike kishte pesuar deformimin e meposhtem:

“Anetaret e Komitetit Qendror ishin ata qe ishin zgjedhur ne Konferencen themelore te PKSH ne Labinot ne mars 1943” (nenvizimi i imi, f. 376).

Ndryshimi qendronte vetem ne nje fjale: nga themeluese ishte transformuar ne themelore. Ne rastin e pare tregonte nje veprim konkret ne kohe, kur ne te dytin pasojen e ngjarjes. A mund te konsiderohet ky transformim nje akt manipulues i historise se Popullit Shqiptar? A nuk ka qene valle kjo arsyeja perse u ribotua per te dyten here vepra e Reginald Hibbert-it? Lexuesi te jete i sigurte qe kjo pune nuk merr fund ketu. Une do te kerkoj botimin origjinal per te pare permasen e manipulimit, per te percaktuar se manipulimin e historise se Popullit Shqiptar intelektualet shqiptare e kane bere me urdher nga jashte apo me urdher nga brenda, pasi te dy rastet nuk jane te barabarte dhe nxjerrin perfundime te kunderta.

Tirane, janar 2015

---

Shenim i Albanovaonline:

Me qe ne te dy botimet shkruhet “Perkthimi i eshte permbajtur me besnikeri origjinalit”, ne nderim te profesionit, i takon perthyesit me e sjelle te plote frazen ne origjinal bashke me skjarimin pse ky ndryshim ne keto dy perkthime.